

**VENDIM**  
**Nr.342, datë 12.5.2010**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME,  
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM  
TË KOMUNËS ANTIGONË TË QARKUT TË GJIROKASTRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Antigone të qarkut të Gjirokastrës, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Antigone të qarkut të Gjirokastrës, miratuar me vendimin nr.1379, datë 17.10.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Antigone të qarkut të Gjirokastrës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Antigone për zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

Komuna Antigone

Lidhja nr.1

| Numrat rendorë të<br>pronave në listën<br>e inventarit | Fusha e përdorimit të pronës                                                                 | Lloji i<br>transferimit |
|--------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------|
|                                                        |                                                                                              |                         |
| 20-27                                                  | Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.                                      | Në pronësi              |
| 28-30                                                  | Prona që përdoren për realizimin e programeve kulturore.                                     | Në pronësi              |
| 31-33                                                  | Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik.                 | Në pronësi              |
| 34                                                     | Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën administrative.                     | Në pronësi              |
| 35,36,38                                               | Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.              | Në pronësi              |
| 37                                                     | Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji. | Në përdorim             |
| 39                                                     | Infrastrukturë (sheshe, lulishte dhe shërbime publike.)                                      | Në pronësi              |
| 40-43                                                  | Varrezat publike.                                                                            | Në pronësi              |

|                |                                                                                                                              |             |
|----------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|
| 45-55          | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).                       | Në përdorim |
| 56-60,64,72,75 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta). | Në pronësi  |
| 80-220         | Infrastrukturë (rrugë vendore).                                                                                              | Në pronësi  |
| 221-226        | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.                                           | Në pronësi  |